



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BULQIZË
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm për Ekonominë dhe kontrollin e
Përndshëm Financiar

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 4 datë 26 /06/ 2025

Nr. ____ Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. Prot 09 datë 19/06/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për “Dhënie e ndihmes financiare”.

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për Veteqeverisjen vendore”, ligjit nr.57, date dt.18.07.2019, “Per asistencen Sociale ne Republikën e Shqiperise”, Ligjit nr 9936, date 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqiperisë”, Udhezimit te Ministrise se Financave dhe ekonomise nr.8, date 20.03.2018 “Per proçedurat standarte te zbatimit te buxhetit”, i ndryshuar,

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Servet Meta është banor I Lagjes së Re, Bashkia Bulqizë. Familja e tij përbëhet prej 5 anëtarësh, Serveti, bashkëshortja e tij, dy djem si dhe një vajzë. z.Servet nuk është I aftë për punë pasi ka disa vite që trajtohet me pagesë invaliditeti për shkak të sëmundjeve që e kanë shoqëruar ndër vite personin në fjalë. Ndaj edhe gjendja social-ekonomike e familjes është e vështirë duke marrë parasysh rrethanat dhe vështirësitë që shoqërojnë familjen në fjalë, vetë Serveti nuk është I aftë për punë, bashkëshortja e tij punon seleksionuese në minierën e kromit, dy djemtë të papunë si dhe vajza e tyre është e vogël. Ndërkohë që Serveti ka disa vite që është me dializë për shkak të sëmundjes që I ka prekur veshkat. Gjithashtu kohët e fundit I është kërkuar një ndërhyrje e menjëhershme në zemër. Duke marrë parasysh shpenzimet e shumta familjare, shpenzimet spitalore për shkak të sëmundjeve të z.Servet përballimi I jetesës bëhet shumë I vështirë për familjen në fjalë duke qenë se sigurojnë të ardhura vetëm nga puna e bashkëshortes së tij si dhe pagesa e invaliditetit të z.Servet.

Ndaj edhe duke parë situatën e vështirë ekonomike në të cilën ndodhet por edhe nevojën për ndërhyrje të menjëhershme që Serveti ka kryer po i drejtohet Bashkisë Bulqizë që ta ndihmojë me

ndonjë ndihmë financiare në mënyrë që të mbulojë borxhet që familja ka marrë për shkak të shpenzimeve spitalore.

Duke parë gjendjen e tij të vështirë ekonomike dhe duke parë situatën e tij shëndetësore: **Situata financiare** : (Shtesa / pakësime në buxhet)

Ti jepet ndihme financiare në masën 50 000 leke të reja që do pakesohen nga buxheti i bashkisë.

Drejtoria /

Spektori përgjegjës

Spektori i shërbimit social

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Prefekti, Keshilli

Impakti social / grupet që preken:

familjet vulnerabel

A është objekt i konsultimit publik:

JO

Komisioni i Përhershëm për "Ekonomine dhe kontrollin" ^{Financiar}, i mbledhur me datën 26/06/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr 8 Prot datë 18/06/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Per dhenien e ndihmës financiare, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash,


VENDOSI


1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak: (qarko njerën)
 - a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
 - b) miratimin e projektaktit
 - c) refuzimin e miratimit të projektaktit
 - d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:

T'i propozojë Këshillit ndryshimet e projekt vendimit si më poshtë vijon te renditura me pika.

1. pa ndryshime

Bashkëlidhur argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Greda Tanc  **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Anjona Horcka  **Sekretar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

